



 <b>Universiteti i Prizrenit</b> <b>University of Prizren</b> <b>Univerziteti Prizren</b> <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar me dt. 28.07.2022	
Zyra e pranimit: ... i protokollit	
308	01-352

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**"UKSHIN HOTI"**  
**KËSHILLI DREJTUES**

**RAPORT I PUNËS**  
**(Janar - Dhjetor 2021)**

## PËRMBAJTJE

TABELAT.....	3
HYRJE.....	4
QEVERISJA E UNIVERSITETIT.....	5
Këshilli Drejtues.....	5
REKTORI.....	6
Aktivitetet e rektoratit.....	6
Stafi akademik dhe administrativ.....	7
Stafi akademik.....	8
Stafi administrativ.....	9
Mësimdhënia.....	11
Programet e studimit.....	11
Çështjet studentore.....	13
Puna e Senatit.....	13
Kërkimet Shkencore.....	13
Buxheti dhe Financat.....	14
1. STUDENTËT.....	15
Numri i studentëve të pranuar në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2021.....	15
Numri i studentëve të pranuar në nivelin master në vitin akademik 2021/2021 .....	16
Përfundim.....	21

## TABELAT

Tabela 1: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit gjatë vitit 2021

Tabela 2: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit akademik gjatë vitit 2021, avancime, pensionime, etj.

Figura 3: Të dhënat statistikore të personelit akademik në total për 2021

Tabela 4: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit administrativ gjatë vitit 2021

Tabela 5: Programet studimore në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren në vitin akademik 2021/2022 në nivelin Baçelor dhe Master

Tabela 6: Numri i publikimeve shkencore të stafit akademik gjatë vitit 2021 në bazë të indeksimit në platforma ndërkombëtare

Tabela 7: Numri i publikimeve shkencore të stafit akademik gjatë vitit 2021 në bazë të njësive akademike

Tabela 8. Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar gjatë periudhës I-XII nga BK dhe Donacionet

Tabela 9. Numri i studentëve të pranuar në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2021

Tabela 10. Numri i studentëve të pranuar në nivelin Master në vitin 2021/2022

Tabela 11: Numri Total i studentëve aktiv në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2022

Tabela 12: Numri Total i studentëve aktiv në nivelin Master në vitin akademik 2021/2022

Tabela 13: Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar në vitin akademik 2020/2021

## HYRJE

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren është themeluar me vendimin nr. 01/87 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me datë 09.10.2009, si universiteti i dytë publik në Republikën e Kosovës. Universiteti filloi me gjeneratën e parë të studentëve në vitin akademik 20010/2011 përkatësisht me 01.10.2010. Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" me seli në Prizren me datë 30.05.2013.

Universiteti përbëhet nga gjashtë fakultete ku organizohen 21 programe të studimeve të dy nivele (Baçelor dhe Master). Programet e studimit i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm të cilësisë. Për këtë qëllim, Universiteti ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë, në të gjitha nivelet. Universiteti përveç programeve studimore në gjuhën shqipe, i ofron studentëve edhe programe të studimit në gjuhën turke dhe boshnjake. Diversiteti gjuhësor i programeve studimore e bënë Universitetin unik, krahasim me Universitetet tjera në Kosovë.

Në këtë Raportin vjetor të punës për vitin 2021, paraqiten të dhënat e përmbledhura zhvillimore për Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Edhe pse Pandemia COVID-19 ndikoi shumë në aktivitetet e universitetit, dhe si rrjedhojë një mori procesesh duhej të përshtateshin sipas kërkesave dhe vendimeve në nivel qendror për të gjitha institucionet si në sektorin publik e ashtu edhe në sektorin privat. Një pjesë e madhe e punëve dhe takimeve u transformuan nga prezenca fizike në virtuale (online).

Ana e mirë e Pandemisë, është përshtatja e stafit në shërbimet online si mundësi e re për realizimin e një sërë takimesh të cilat jo domosdoshmrishtë duhet të mbaheshin në prezencë fizike, dhe kjo dha efektet e veta sidomos gjatë procesit të riakreditimit të programeve të studimeve ku takimet mbaheshin më të shpeshta dhe me më shumë pjesëmarrës në takime. E gjithë kjo periudhë ishte mjaftë sfiduese në aspektin menaxherial, ku me përgjegjësi dhe punë intensive thuajse të gjitha aktivitete dhe objektivat e Universitetit janë menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Edhe gjatë vitit 2021 puna në universitet është bazuar në Planin Strategjik të 2020-2024, i cili është i ndërtuar mbi shtatë objektivat strategjike: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie; Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore; Kontributi në komunitet; Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit; Zhvillimi i infrastrukturës; Digjitalizimi dhe sistemi i integruar i të dhënave; dhe Qëndrueshmëria financiare.

Këto objektiva strategjike jemi duke punuar që të zbërthehen në rezultatet e pritura për Universitetin.

Gjatë vitit 2021, me mbështetje dhe nga Projekti HerasPlus është bërë rishikimi i implementimit të objektivave strategjike. Në këtë kuadër Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren ka hartuar edhe Kornizën për vlerësimin e performancës duke u mbështetur në objektivat pesë vjeçare të Planit strategjik 2020-2024. Kjo kornizë e vlerësimit të performancës shërben për monitorimin e zbatimit të Planit strategjik.

Korniza për vlerësimin e performancës përfshinë treguesit kryesorë për të cilët mund të sigurohet të dhëna të matshme dhe të krahasueshme. Korniza përshinë vlerat për gjendjen aktuale (2021) dhe vlerat të cilat aspiron t'i përmbushë gjatë periudhës së zbatimit të Planit strategjik.

Pra ,Korniza për vlerësimin e performancës përcakton treguesit mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi për secilin nga shtatë objektivat e strategjisë dhe si e tillë përmban caqet që duhet arritur gjatë periudhës së zbatimit të Planit, si dhe gjendjen e tanishme të treguesve.

Kjo kornizë është prezantuar në bashkëlidhur, në formë të shtatë tabelave, për secilin objektiv strategjik.

## QEVERISJA E UNIVERSITETIT

Autoritetet kryesore qeverisëse të Universitetit janë Këshilli drejtues, Rektori dhe Senati

### Këshilli Drejtues

Këshilli drejtues i Universitetit është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Këshilli drejtues ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të Universitetit. Këshilli drejtues është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura), në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit në përputhje me detyrimet e tij.

Gjatë vitit 2021 Këshilli Drejtues i Universitetit ishte mjaftë aktiv në realizimin e detyrave statutare.

Këshilli Drejtues gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, i ka mbajtur 19 mbledhje dhe ka miratuar 30 vendime dhe 42 konkluzione.

## REKTORI

Rektori është autoriteti kryesor menaxhues i Universitetit, i cili është përgjegjës për punën efektive dhe të rregullt të Universitetit dhe për menaxhimin e tij sipas politikës së përcaktuar nga Këshilli drejtues dhe ka gjithë autoritetin e nevojshëm për ushtrimin e këtyre detyrave. Pas përfundimit të mandatit të rektorit paraprak, rektori aktual vazhdoi detyrën si ushtrues detyre e më pas u shpall edhe konkursi ku i njëjti u zgjodh edhe rektor.

### Aktivitetet e rektoratit

Aktivitetet e rektoratit zhvillohen në koordinim me kabinetin e rektorit. Rektori në kuadër të kabinetit të tij ka këtë përbërje:

- Tre prorektorë
- Dy këshilltar
- Një asistente

Për këtë periudhë kohore janë zhvilluar një mori aktivitete, ndër të cilat janë bashkëpunimet ndërkombëtare dhe vendore, takime të shumta zyrtare, mbajtje të mbledhje të Këshillit Drejtues si dhe të Senatit, formim të Komisioneve dhe Rregulloreve të Universitetit.

Gjatë kësaj periudhe janë arritur marrëveshje të bashkëpunimit me këto universitete e institucione ndërkombëtare:

- University of Economics and Human Sciences, Ęarsaė, Poland
- Universiteti POLIS, Tiranė
- Bursa Uludag University, Turkey
- University "ST KLIMENT OHRIDSKI" Bitola
- University of Loėa, USA
- Suleyman Demirel University, Turkey
- Public Diplomacy Section of the U.S. Embassy Pristina
- Agjencia e Zbatimit të Gjuhės së RMV-sė, Shkup

Janė arritur edhe këto marrëveshje bashkëpunimi me partnerė vendor :

- Evonem LLC
- Grupi joformal "Malala"
- IATP-Integrated Agricultural Technologx Agency L.L.C

## Stafi, mësimdhënia, kërkimet shkencore, çështjet studentore dhe puna e senatit

Universiteti në zinxhirin e punëve ka në përbërje stafin akademik dhe stafin administrativ të cilat kanë një seri aktiviteteve si në kuadër të proceseve mësimore ashtu edhe në kuadër të proceseve dhe procedurave të menaxhimit.

Këtë vit një pjesë e madhe e stafit akademik dhe administrativ janë pajisur me kompjuter dhe pajisje tjera të teknologjisë si nevojë për përmbushjen e detyrave dhe proceseve të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e mësimin.

### Stafi akademik dhe administrativ

Tabela 1: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit gjatë vitit 2021 në një pasqyrë të shkurtë.

Stafi	Grupi		Grand Total
	Për. Administ.	Për. akademik	
Avancim	4	14	18
Dorëheqje		2	2
Ngrirje pozitive		2	2
Pensionim	2		2
Rikthim		1	1
Rizgjedhje		5	5
Vdekje		2	2
Zëvendësim	5		5
Zgjedhet /Staf i ri	2	4	6
<b>Grand Total</b>	<b>13</b>	<b>30</b>	<b>43</b>

## Stafi akademik

Tabela 2: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit akademik gjate vitit 2021 si avancime, pensionime etj... janë të paraqitura shkurtimisht në tabelën në vijim

Grupi	Për. akademik								
Stafi		Ndryshimi							
PARA	PAS	Avancim	Dorëheqje	Ngrirje	Rikthim	Rizgjedhje	Vdekje	Zgjedhet	Grand Total
---	Asistent-e							1	1
	Prof.asoc.dr.	1							1
	Prof.ass.dr.							3	3
Asistent-e	Asistent-e					4			4
	Deputete/Kuvend			1					1
	Dorëheqje		1						1
	Prof.ass.dr.	1							1
Prof.asoc.dr.	Dorëheqje		1						1
	Prof.asoc.dr.					1			1
	Vdekje						1		1
Prof.ass.dr.	Prof.asoc.dr.	12							12
	Prof.ass.dr.				1				1
	Rektor UGJFA			1					1
	Vdekje						1		1
<b>Grand Total</b>		<b>14</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>30</b>



Figura 3: Të dhënat statistikore të personelit akademik në total për 2021

Njësia Akademike /Fakulteti	Prof.dr.	Prof.asoc.dr	Prof.ass.dr	Lektor	Asistent
Fakulteti i Ekonomisë	0	8	3	0	6
F. Shkencave Kompjuterike	0	4	2	0	3
Fakulteti Juridik	0	6	4	0	5
Fakulteti i Edukimit	0	11	9	0	2
Fakulteti i Filologjisë	0	5	3	0	2
F.Sh. të Jetës dhe Mjedisit	0	1	7	0	2
<i>Totali sipas thirrjes akademike</i>	0	35	28	0	20
	Totali				83

### Stafi administrativ

Të gjitha aktivitetet brenda dhe jashtë universitetit kërkojnë mbështetje, punë, shërbime, apo edhe aktivitete tjera varësisht nga nevojat e stafit akademik, menaxhmentit, njësive akademike, njësive administrative.

Administrata angazhimin e vet e gërshetohen të tri shtyllat funksionale të Universitetit në pjesën menaxheriale, pjesën financiare dhe çështjet tjera të infrastrukturës dhe teknologjisë.

Në kohë pandemie varësisht prej gjendjes shëndetësore të stafit, ata kanë ushtruar dhe detyra të ndryshme për mbështetje të stafit në kohë pandemie dhe një pjesë e madhe e punëve janë bërë edhe në kushte shtëpie por pa paraqitur pengesa në raport me përmbushjen e kërkesave si të stafit edhe të studentëve, pra, pandemia krijoi një administratë hibride e cila funksiononte edhe në kushte tradicionale dhe në kushte virtuale.

Vlen të theksohet se efikasiteti i administratës ka qenë në nivel në raport me punët që ata kanë pasur si në kushte shtëpie ashtu edhe në zyrë dhe nuk është raportuar ndonjë ngecje apo mungesë e shërbimeve edhe pse punohej në vende dhe kushte të ndryshme. Është mbresëlënëse bashkëpunimi, partneriteti i administratës në kushte pandemie të cilët kanë ndihmuar njëri tjetrin në përmbushje të detyrave.

Sfidë dhe ngarkesë të veçantë në kushte pandemie ka pasur Zyra e TI-së e cila edhe në prezencë fizike por edhe online rregullisht ka qenë më e kërkuara për shërbime dhe përkrahje.

Kjo ka ndikuar që për vitin 2022 një pjesë e madhe e investimeve të koncentrohen në infrastrukturën e TI-së dhe shërbimeve të ofruara nga zyra e TI-së sepse infrastruktura aktuale tashmë është amortizuar dhe vjetërsuar dhe nuk ka kapacitete që të mbështesë kërkesat e sistemeve apo platformave të cilat kanë evoluar gjatë këtij dhjetëvjeçarit të fundit.

Personeli administrativ i Universiteti "Ukshin Hoti" në vitin 2021, në bashkëpunim me IKAP ka realizuar

trajnim (on-line) për personelin administrativ të Universitetit në këto tema :

- Cikli i menaxhimit të projektit (17-18. 05. 2021)
- Hartimi i shkresave zyrtare dhe komunikimi zyrtar (24-25.05.2021)
- Menaxhimi i kontratës (01.06.2021)
- Lidershipi dhe zhvillimi i aftësive menaxhuese (09-10.06.2021)

Tabela 4: Ndryshimet dhe lëvizjet e stafit administrativ gjate vitit 2021

Grupi	Për. Administ.	Ndryshimi				
Stafi		Avancim	Pensionim	Zëvendësim	Zgjedhet	Grand Total
PARA	PAS					
---	Z. për lekturim				1	1
	Z. në Senat				1	1
Sekretar F.	Zv.Sekretar i për.			1		1
Udhëheqëse	Pension		2			2
Z. Arkiv	K.karrierë/alumni	1				1
Z. Cilësi	U. Z. Për Cilësi	1				1
Z. Paga	U. i Projekteve	1				1

Z. të hyra/sh	Drejtor buxhet/fin.			1		1
Z. Zotim	U. kërkime shken			1		1
Z.Bibliotekë	Udhëheqës i B.			1		1
Z.Personelit	Menaxher i P.	1				1
Z.studentëve	Udhëheqës i Sh.s			1		1
<b>Grand Total</b>		<b>4</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>13</b>

## Mësimdhënia

Mësimdhënia gjati viti 2021 ishte e mundimshme për të gjitha palët e interesit. Në zinxhirin e punëve Universiteti ka në përbërje stafin akademik dhe stafin administrativ të cilat kanë një seri aktiviteteve si në kuadër të proceseve mësimore ashtu edhe në kuadër të proceseve dhe procedurave të menaxhimit e të gjitha këto për të ofruar mësimdhënie të suksesshme dhe efektive.

Pandemia edhe këtu ndikoi duke krijuar sfida të reja në procesin e mësimdhënies për të përshtatur ambientet e mësimin bazuar në rregulla dhe vendime të zbatueshme për punë në kushte pandemie dhe si rrjedhojë edhe procesi i mësimin ishte mjaft kompleks për sa i përket përmbushjes së planit dhe programit të studimeve.

Zvogëlimi i prezencës së studentëve nëpër ligjërata dhe ushtrime ishte mjaft kompleks për tu menaxhuar nga mësimdhënësit të cilët duhej të respektonin rregullat dhe vendimet dhe ligjet në fuqi në situatë pandemie.

Këtë vit në të gjitha ambientet e mësimin u bënë ndryshime në aspektin e teknologjisë ku u zëvendësuan pajisjet multimediale të amortizuara dhe të dëmtuara me pajisje të reja të cilat i dhanë një frymë të re edhe mësimdhënies në ambientet e mësimin.

## Programet e studimit

Gjatë vitit 2021 në Universitet ju kanë nënshtruar riakreditimit 9 programe studimore, prej tyre 8 janë riakredituar ndërsa 1 nuk janë riakredituar.

Vlen të theksohet se më 2021 është akredituar programi i ri studimor në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit – Menaxhim në Agrobiznes.

Tabela 5: Programet studimore në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren në vitin akademik 2021/2022 në nivelin Bachelor dhe Master

	Study Program Albanian	Campus	Level	ECTS	Approved quota	Accredited Until
1	Administrim Biznesi	Prizren	Bsc	180	150	30.9.2022
2	Dizajn Softueri	Prizren	BSc	180	180	30.9.2022
3	Juridik	Prizren	LLB	240	180	30.9.2022
4	Menaxhment Nderkombetare	Prizren	BSc	180	200	30.9.2022
5	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi	Prizren	BSc	180	180	30.9.2022
6	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Boshnjakisht	Prizren	BSc	180	30 ne vitin 2020	30.9.2022
7	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Turqisht	Prizren	BSc	180	30 ne vitin 2020	30.9.2022
8	Programi Parashkollor - Boshnjakisht	Prizren	BA	240	40 ne vitin 2020	30.9.2022
9	Programi Fillor - Boshnjakisht	Prizren	BA	240	40 ne vitin 2020	30.9.2022
10	Programi Parashkollor - Turqisht	Prizren	BA	240	40 ne vitin 2020	30.9.2022
11	Programi Fillor - Turqisht	Prizren	BA	240	40 ne vitin 2020	30.9.2022
12	Programi Parashkollor	Prizren	BA	240	95	30.9.2024
13	Programi Fillor	Prizren	BA	240	70	30.9.2024
14	Shkenca e Pyjeve dhe të Mjedisit	Prizren	BSc	180	50	30.9.2024
15	Agrobiznes	Prizren	BSc	180	80	30.9.2024
16	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	Prizren	BA	240	40	30.9.2024

17	Gjuhe dhe Letërsi Angleze	Prizren	BA	240	120	30.9.2026
18	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	Prizren	BA	180	100	30.9.2024
19	Menaxhim në Agrobiznes	Prizren	MSC	120	15	30.9.2024
20	Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi	Prizren	Msc	120	45	30.9.2024
21	Administrim Biznesi	Prizren	MSc	120	80	30.9.2023

### Çështjet studentore

Çështjet studentore gjithashtu pësuan ndryshime në raport me trajtimet e mëparshme tradicionale si pasojë e pandemisë dhe takimet dhe aktivitetet me studentë ishin mjaft të kufizuara, pra, aktivitetet e studentëve pothuajse kanë ngelur pothuajse të ngrira.

### Puna e Senatit

Senati ka vazhduar punët e tij në vendimmarrjet dhe takimet e rregullta të cilat i ka mbajtur në dy formatet edhe me prezencë fizike edhe atë virtuale varësisht prej kushteve dhe gjatë kësaj periudhe ka marrë një sërë vendimesh të cilat janë zbatuar nga palët e interesit. Gjatë vitit 2021, Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren ka mbajtur gjithsej 20 mbledhje të janë miratuar 128 vendime.

### Kërkimet Shkencore

Tabela 7: Numri i publikimeve shkencore të stafit akademik gjatë vitit 2021 në bazë të njësive akademike

Nr.	Fakulteti	Numri i publikimeve shkencore
1	FAKULTETI I EDUKIMIT	13
2	FAKULTETI I EKONOMISË	10
3	FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE	8

4	FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT	9
5	FAKULTETI JURIDIK	9
6	FAKULTETI I FILOLOGJISË	4
	Total:	53

Tabela 6: Numri i publikimeve shkencore të stafit akademik gjatë vitit 2021 në bazë të indeksimit në platforma ndërkombëtare

Platforma	Numri i publikimeve
WoS	9
Scopus	27
EBSCO	29
WorldCat	38
DOAJ	17

### Buxheti dhe Financat

Për vitin kalendarik 2021 buxheti i lejuar dhe shpenzuar i UUHP është si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8: Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar gjatë periudhës I-XII nga BK dhe Donacionet

Nr. Rend.	Kategoria ekonomike	Ndarja buxhetore sipas Ligjit buxhetor 2021
1	2	3
1. a.	Pagat dhe shtesat (BK)	1,347,540.00
1.b.	Të hyrat vetjake	303,188.00
1.c.	Të hyrat vetiake nga viti i kaluar	-
2	Mallra dhe shërbime	600,000.00
3	Shpenzimet komunale	73,000.00
4	Subven. dhe transferet	100,000.00
5	Investimet kapitale	180,000.00
8	Gjithsej-me të HV	2,603,728.00

## 1. STUDENTËT

Elementë kritik për proceset dhe punët e universitetit janë studentët të cilët çdo vit akademik aplikojnë për regjistrim në universitet..

Gjatë vitit 2021 janë mbajtur edhe zgjedhjet studentore, ku janë zgjedhur përfaqësuesit e studentëve nëpër këshillat studentore të fakulteteve, parlamentin studentor dhe përfaqësuesit e studentëve në Senat dhe këshillat e fakulteteve.

Po ashtu studentët janë përkrahur me bursa studentore.

Në vijim do të gjeni disa tabela të cilat prezantojnë shkurtimisht studentët dhe shpërndarjen e tyre në njësitë akademike

### Numri i studentëve të pranuar në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2021

Në bazë të programeve të themeluara dhe te akredituar-ri akredituar nga AKA-ja universiteti i Prizrenit çdo vit shpallë konkurs për pranimin e studentëve të rinj për çdo program studimi i cili përcakton edhe numrin e studentëve për pranim sipas kuotave të miratuara nga AKA-ja.

Tabela 9: Numri i studentëve të pranuar në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2022

Fakulteti /Programi i studimit	Viti i I-rë		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
EKONOMIK/ ADMINISTRIM BIZNESI	86	64	150
EKONOMIK/ MENAXHMENT NDERKOMBETAR	79	66	139
JURIDIK/ JURIDIK	115	45	166
FSHK/ SOFTËARË DESING	30	76	106
FSHK/ TIT-SHQIP	20	52	72
FSHK/ TIT-BOSHNJAKE	7	23	30
FSHK/ TIT-TURKE	5	7	12
EDUKIM/ P.FILLOR-SHQIP	44	6	50
EDUKIM/ P.FILLOR-BOSHNJAKE	4	12	16
EDUKIM/ P.FILLOR-TURKE	9	5	14

**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-SHQIP	40	0	40
EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-BOSHNJAKE	7	1	8
EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-TURKE	18	2	20
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI SHQIPE	35	4	39
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI ANGLEZE	76	38	114
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI GJERMANE	77	23	100
FSHJMJ/ AGROBIZNES	20	22	42
FSHJMJ/ SHKENCAT E PYJEVE DHE MEJDISIT	16	10	26
<b>Gjithsej</b>	<b>682</b>	<b>468</b>	<b>1144</b>

**Numri i studentëve të pranuar në nivelin master në vitin akademik 2021/2021**

Në bazë të programeve të themeluara dhe të akredituar-ri akredituar nga AKA-ja universiteti i Prizrenit çdo vit shpallë konkurs për pranimin e studentëve të rinj për çdo program studimi i cili është i akredituar nga AKA-ja.

**Tabela 10: Numri i studentëve të pranuar në nivelin Master në vitin 2021/2022**

Fakulteti /Programi i studimit	Femra	Meshku	Gjithsej
EKONOMIK/ MASTER ADMINISTRIM BIZNESI	52	28	80
EKONOMIK/ MASTER KONTABILITET DHE AUDITIM	0	0	0
EKONOMIK/ MENAXHIM NË AGROBIZNES	0	0	15
FSHK/ MASTER SHKENCAT KOMPJUTERIKE	15	30	45
<b>Gjithsej</b>	<b>67</b>	<b>58</b>	<b>140</b>



Tabela 11: Numri Total i studentëve aktiv në nivelin Baçelor në vitin akademik 2021/2022

NR. AKTIV 2021/22			
Fakulteti /Programi i studimit	Femra	Meshkuj	Gjithsej
EKONOMIK/ ADMINISTRIM BIZNESI	218	149	367
EKONOMIK/ MENAXHMENT NDERKOMBETAR	230	121	351
JURIDIK/ JURIDIK	398	162	560
FSHK/ SOFTËARE DESING	66	147	213
FSHK/ TIT-SHQIP	69	117	186
FSHK/ TIT-BOSHNJAKE	22	47	69
FSHK/ TIT-TURKE	11	17	28
EDUKIM/ P.FILLOR-SHQIP	269	29	298
EDUKIM/ P.FILLOR-BOSHNJAKE	34	26	60
EDUKIM/ P.FILLOR-TURKE	31	10	41
EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-SHQIP	287	3	290
EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-BOSHNJAKE	24	3	27
EDUKIMIT/ P.PARAFILLOR-TURKE	48	2	50
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI SHQIPE	184	22	206
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI ANGLEZE	208	67	275
FILOLOGJIK/ GJUHE DHE LETERSI GJERMANE	138	37	175
FSHJMJ/ AGROBIZNES	43	47	90
FSHJMJ/ SHKENCAT E PYJEVE DHE MEJDISIT	18	41	59
<b>Gjithsej</b>	<b>2298</b>	<b>1017</b>	<b>3315</b>

Tabela 12: Numri Total i studentëve aktiv në nivelin Master në vitin akademik 2021/2022

Fakulteti /Programi i studimit	NR AKTIV MASTER 2021/22		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej
EKONOMIK/ MASTER - ADMINISTRIM BIZNESI	89	52	141
EKONOMIK/ MASTER - KONTABILITET DHE AUDITIM	27	27	54
EKONOMIK/ MASTER -TRASHEGIMIA KULTURORE DHE MENAXHIMI NE TURIZËM	1	1	2
FSHK/ MASTER - SHKENCAT KOMPJUTERIKE	31	60	91
FSHMJ/MASTER-	9	6	15
<b>Gjithsej</b>	<b>157</b>	<b>146</b>	<b>303</b>

Tabela 13: Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar në vitin akademik 2020/2021

Nr.	Programi	Gjinia	2020/21
1	EKONOMIK-ADMINISTRIM BIZNESI	F	66
		GJ	104
2	EKONOMIK-MENAXHMENT NDERKOMBETAR	F	42
		GJ	64
3	JURIDIK	F	58
		GJ	87
4	FSHK-SOFTËARE DESING	F	8
		GJ	32
5	FHK-TIT	F	13
		GJ	31
6	FSHK-TIT - BOSHNJAK	F	3

		GJ	8
7	FSHK-TIT /TUR/	F	1
		GJ	3
8	EDUKIMI -GJUHE GJERMANE	F	0
		GJ	0
9	EDUKIM-GJUHE SHQIPE	F	0
		GJ	0
10	EDUKIM-KIMI-FIZIKE	F	0
		GJ	0
11	EDUKIM-HEMIJA-FIZIKA /BOS/	F	0
		GJ	0
12	EDUKIMI -GJUHE ANGLEZE	F	0
		GJ	0
13	EDUKIM-PROGRAMI FILLOR	F	178
		GJ	202
14	EDUKIM-FILLOR BOSHMIJAK	F	8
		GJ	18
15	EDUKIM-PROGRAMI FILLOR / TUR/	F	11
		GJ	13
16	EDUKIM-PROGRAMI PARAFILLOR	F	121
		GJ	121
17	EDUKIM-PROGRAMI PARAFILLOR/ BOS/	F	6
		GJ	14
18	EDUKIM-PROGRAMI PARAFILLOR/TUR/	F	10
		GJ	10
19	EDUKIM-KIMI-FIZIKE /GJUHE TURKE/	F	0
		GJ	0
20	EDUKIM-MATEMATIKE-INFORMATIKE	F	0
		GJ	0
20	EDUKIM-MATEMATIKE-INFORMATIKE/ BOS/	F	0
		GJ	0
21	EDUKIM-MATEMATIKE- INFORMATIKE/TUR/	F	0
		GJ	0
22	EDUKIM-BOSANSKI JEZIK	F	0
		GJ	0

23	FILOLOGJIK - GJUHE SHQIPE	F	23
		GJ	28
24	FILOLOGJIK - GJUHE ANGLEZE	F	43
		GJ	53
25	FILOLOGJIK - GJUHE GJERMANE	F	27
		GJ	34
26	FSHMJ-SHKENCAT E PYJEVE DHE MJEDISIT	F	5
		GJ	14
27	FSHMJ-AGROBIZNES	F	9
		GJ	15
28	MASTER ADMINISTRIM BIZNESI	F	28
		GJ	43
29	MASTER AUDITIM	F	18
		GJ	31
30	MASTER TRASHEGIMIA KULTURORE	F	2
		GJ	8
31	MASTER SHKENCAT KOMPJUTERIKE	F	21
		GJ	31
32	MASTER MENAXHIM NË AGROBIZNES	F	0
		GJ	0
	GJITHSEJ	F	701
		GJ	964

## Përfundim

Edhe në vitin 2021, Pandemia Covid-19 vazhdojë me ritme të shpejta të përhapjes, duke vështirësuar zhvillimin e aktiviteteve ditore dhe proceset e punës. Padyshim, edhe Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren është ndikuar nga Pandemia Covid-19 duke u ballafaquar me një periudhë sfiduese pothuajse, në të gjitha nivelet menaxhuese. Krahas kësaj, organet drejtuese dhe menaxhmenti i Universitetit janë përpjekur në koordinimin dhe organizimin e punës si në mobilizimin e stafit akademik dhe atë administrativ dhe është punuar në arritjen e objektivave. E gjithë kjo përpjeke është bërë për të siguruar shërbimet sa më të mira për studentët tanë.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues